



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 08 korrik 2019  
Nr. ref.:RK 1391/19

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI166/18**

Parashtrues

**Limak Kosovo International Airport SH. A. “Adem Jashari”**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjkimit të Gjykatës Supreme të  
Kosovës, Rev. nr. 219/2018, të 3 shtatorit 2018**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është parashtruar nga shoqëria aksionare Limak Kosovo International Airport SH. A. “Adem Jashari” (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me seli në fshatin Vrellë, komuna e Lipjanit, e cila përfaqësohet me autorizim nga Fazli Gjonbalaj dhe Leonora Fejzullahu.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 219/2018, të 3 shtatorit 2018.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes të cilit parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 4, të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafin 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 3 shtator 2018, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesat KI128/18, KI129/18 dhe KI130/18 në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 5 shtator 2018, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesën KI132/18 në Gjykatë.
7. Më 21 shtator 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi, si në rastin KI128/18.
8. Më 21 shtator 2018, Kryetarja e Gjykatës me urdhër i bashkoi rastet KI128/18, KI129/18, KI130/18 dhe KI132/18, me të njëjtin gjyqtar raportues dhe Kolegji shqyrtues si në rastin KI128/18.
9. Më 25 shtator 2018, parashtruesi dorëzoi kërkesat KI164/18, KI165/18, KI166/18 dhe KI167/18 në Gjykatë.
10. Më 5 nëntor 2018, Kryetarja e Gjykatës me urdhër i bashkoi rastet KI128/18, KI129/18, KI130/18 dhe KI132/18, me rastet KI164/18, KI165/18, KI166/18 dhe KI167/18 me të njëjtin gjyqtar raportues dhe Kolegji shqyrtues si në rastin KI128/18.

11. Më 8 nëntor 2018, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin dhe bashkimin e kërkesave KI164/18, KI165/18, KI166/18 dhe KI167/18 me kërkesat KI128/18, KI129/18, KI130/18, KI132/18.
12. Më 6 dhjetor 2018, parashtruesi i kërkesës parashtroi një shkresë në Gjykatë dhe i bashkëngjiti dy vendime të Gjykatës Themelore në Prishtinë - dega në Lipjan, si dhe një vendim të Gjykatës së Apelit. Ai kërkoi që këto shkresa t'i bashkohen rasteve KI129/18 dhe KI166/18. Me këto dokumente shtesë, parashtruesi donte të tregonte praktika të ndryshme të gjykatave të rregullta në procesin e vendimmarrjes.
13. Më 4 prill 2019, Kryetarja e Gjykatës me urdhër ndau rastet e bashkuara KI128/18, KI129/18, KI130/18, KI132/18, KI164/18, KI165/18, KI166/18 dhe KI167/18 në raste individuale, me gjyqtarin raportues dhe Kolegjin shqyrtues të njëjtë si në rastin KI128/18.
14. Më 12 prill 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme se rastet KI128/18, KI129/18, KI130/18, KI132/18, KI164/18, KI165/18, KI166/18 dhe KI167/18 janë ndarë me urdhër dhe se ato do të shqyrtohen individualisht në Gjykatën Kushtetuese.
15. Më 12 prill 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi një shkresë të titulluar "[...] lidhur me lëndët e regjistruara në Gjykatën Kushtetuese dhe në veçanti për lëndën e regjistruar me [...] numër KI132/18".
16. Më 16 maj 2019, parashtruesi i kërkesës përsëri dërgoi një shkresë të titulluar "*Parashtrësë, lidhur me lëndët e regjistruara në Gjykatën Kushtetuese*", në të cilën ai në thelb i përsëriti pretendimet që kishte bërë më parë.
17. Më 20 qershor 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve**

18. Më 12 gusht 2010, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe parashtruesi i kërkesës kishin nënshkruar Marrëveshje të Partneritetit Publiko-Privat (në tekstin e mëtejshëm: PPP). Para nënshkrimit të marrëveshjes së PPP-së, Aeroporti i Prishtinës quhej Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës (në tekstin e mëtejshëm: ANP).
19. Në bazë të shkresave të lëndës vërehet se e punësuar SH. G. (në tekstin e mëtejshëm: e punësuar) kishte qenë e punësuar tek ANP-ja. E punësuar SH. G. kishte themeluar marrëdhënie pune me ANP-në prej 14 shkurtit 2005 deri më 3 prill 2011. Bazuar në Marrëveshjen e PPP-së, parashtruesi i kërkesës kishte marrë obligim që të gjithë punëtorët t'i mbajë në marrëdhënie të punës për 3 (tri) vite. Bazuar në Marrëveshjen e PPP-së, parashtruesi i kërkesës e ka pranuar të punësuarën SH. G., sipas kontratës me kohë të caktuar në kohëzgjatje prej 3 (tri) vitesh, përkatësisht nga 3 prilli 2011 deri më 3 prill 2014.

20. Më 3 mars 2014, përkatësisht 30 (tridhjetë) ditë para skadimit të kontratës me kohë të caktuar, parashtruesi i kërkesës njoftoi të punësuarën SH. G. se kontrata e saj ka përfunduar përmes një *“Njoftimi për mospërtëritje të kontratës së punës”* dhe arsyetoi se kjo gjë bazohet në *“[...] vendimin e kompanisë për planifikimin e ardhshëm të resurseve njerëzore”*. Nga ana tjetër, si bazë ligjore për mosvazhdimin e kontratës së punës, parashtruesi u bazua në paragrafin 2, të nenit 71 të Ligjit të Punës si dhe kontratën e punës.
21. Më 16 mars 2014, e punësuar SH. G., duke konsideruar se njoftimi i 3 marsit 2014 është i kundërligjshëm, paraqet tek parashtruesi i kërkesës propozim që ky njoftim të anulohet si joligjor, si dhe kërkon nga parashtruesi t’a kthen në vendin e mëparshëm të punës, me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës.
22. Më 20 mars 2014, parashtruesi i kërkesës refuzoi si të pabazuar kërkesën e të punësuarës që njoftimin për mosipërtëritje të kontratës ta anulojë si joligjor.
23. E punësuar paraqiti kërkesëpadi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-dega në Lipjan (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), ku kërkoi që të anulohet njoftimi i 3 marsit 2014, si dhe përgjigja e parashtruesit të kërkesës e 20 marsit 2014 për mosvazhdimin e kontratës së punës, të lëshuar nga parashtruesi i kërkesës, dhe të obligohet parashtruesi i kërkesës që të punësuarën ta kthejë në punë me të gjitha të drejtat dhe obligimet, si dhe e obligoi që t’ia kompensojë dëmin e shkaktuar material.
24. Më 3 qershor 2015, Gjykata Themelore në Prishtinë-dega në Lipjan (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), përmes Aktgjykimit C. nr. 213/2014 refuzoi, si të pabazuar, padinë e SH. G. duke u thirrur në dispozitën e nenit 67, pika 1.3 të Ligjit të Punës, me të cilin parashihet *“[...] Ndërprerja e marrëdhënies së punës sipas fuqisë ligjore, përveç rasteve tjera, ndërprehet edhe me skadimin e kohëzgjatjes së kontratës”*. Prandaj, në rastin konkret, sipas Gjykatës Themelore meqë e punësuar nuk ka mbushur 10 (dhjetë) vite e më tepër përvojë pune, për t’u konsideruar se është në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar, atëherë *“[ parashtruesi i kërkesës] nuk ka pasur obligim ligjor që t’ia vazhdojë kontratën e punës [të punësuarit]”*, meqë asaj iu ishte ndërprerë marrëdhënia e punës me skadimin e kontratës së punës përkatësisht, sipas fuqisë ligjore.
25. Në një datë të pacaktuar, e punësuar SH. G. parashtroi ankesë kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.
26. Më 5 prill 2018, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit Ac. nr. 3632/2015 refuzoi, si të pabazuar, ankesën e të punësuarës dhe njëkohësisht e vërtetoi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, duke theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore sepse e punësuar nuk ka mbushur 10 (dhjetë) vite e më tepër përvojë pune tek parashtruesi i kërkesës për t’u konsideruar se kishte marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar. Andaj, Gjykata e Apelit e konsideroi se vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë është i ligjshëm dhe i rregullt.
27. Në një datë të pacaktuar, e punësuar SH. G. parashtroi revizion kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe shkallës së dytë. E punësuar në revizion kërkoi që revizioni i paditësit të aprovohet si i bazuar dhe që të

ndryshohen aktgjykimet e dy gjykatave të instancave më të ulët, në mënyrë që kërkesëpadia e paditësit të aprovohet si e bazuar dhe i padituri të detyrohet t'i kompensojë shpenzimet e procedurës, ose të anulojë aktgjykimet e dy gjykatave dhe rasti kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

28. Më 3 shtator 2018, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit Rev. nr. 219/2018, e aprovoi si të bazuar revizionin e paraqitur nga e punësuar dhe ndryshoi aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit.
29. Gjykata Supreme me Aktgjykimin Rev. nr. 219/2018 (i) aprovoi revizionin e punëtores si të bazuar, (ii) anuloi njoftimin e parashtruesit të kërkesës të 3 marsit 2014, si dhe përgjigjen e parashtruesit të kërkesës të 20 marsit 2014 për mosvazhdimin e kontratës së punës, (iii) obligoi parashtruesin e kërkesës ta kthejë të punësuarën në vendin e mëparshëm të punës, (iv) obligoi parashtruesin e kërkesës t'i paguajë të punësuarës një shumë të caktuar në emër të dëmit material, dhe (v) obligoi parashtruesin e kërkesës të mbulojë shpenzimet e procedurës kontestimore.
30. Më tej, Gjykata Supreme arsyetoi se *"[parashtruesi i kërkesës] ka dështuar për të vërtetuar të gjitha pretendimet e tij lidhur me ligjshmërinë për mosvazhdimin e kontratës së punës së [të punësuarës] si dhe vërtetimi i fakteve relevante nëse [parashtruesi i kërkesës] ka përpiluar një plan të detajuar operativ, në të cilin do të përcaktohej se cilat shërbime mund të reduktohen dhe në çfarë përfshirje do të ishin reduktuar, me qëllim të vërtetimit të faktit se provat e parashtruara, paraqesin bazë të vlefshme ligjore për mospërtërirjen e kontratës së punës [...], andaj, dështimi i [parashtruesit të kërkesës] në këtë drejtim për mosvazhdimin e kontratës së punës e bën të paligjshëm"*.
31. Më tutje, Gjykata Supreme kishte vlerësuar se objekt i kërkesëpadisë së të punësuarës *"ishte vlerësimi i ligjshmërisë së njoftimit për mosvazhdimin e kontratës së punës dhe jo vërtetimi i ekzistimit të marrëdhënies së punës në kohë të pacaktuar, i cili njoftim është marrë në kundërshtim me Ligjin e Punës"*, duke konsideruar kështu që gjykatat e instancave më të ulëta e kanë vërtetuar drejt situatën faktike, por kanë zbatuar gabimisht të drejtën materiale.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

32. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se *"Gjykata Supreme e Kosovës Aktgjykimi Rev. nr. 219/2018, [...], ka shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 24 dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], për shkak të mosarsyetimit të vendimit gjyqësor, duke pohuar me tej se "Si pasojë e mungesës së arsyetimit që bazohet në fakte, vendimi i kontestuar e privoi parashtruesin e kërkesës nga e drejta kushtetuese për mjet efektiv juridik" dhe me këtë atij i është shkelur edhe e drejta e garantuar me nenin 32 dhe si pasojë e këtyre shkeljeve, parashtruesit i është cenuar edhe e drejta e pronës sipas nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës. Parashtruesi pohon gjithashtu, se ka shkelje të nenit 6.1 [E drejta për një proces të rregullt] i KEDNJ-së"*.



33. Parashtruesi i kërkesës në thelb arsyeton kërkesën e tij duke theksuar:
- (i) Se Gjykata Supreme ka dalë përtej kërkesës së revizionit kur interpretoi nenin 5, paragrafi 1 të Ligjit të Punës.
  - (ii) Se Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit kanë zbatuar në mënyrë të drejtë ligjin në lidhje me nenin 1.1 dhe nenin 67, paragrafi 1.3, si dhe nenin 71 paragrafi 2 të Ligjit të Punës, 03/L-212, ndërsa Gjykata Supreme ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale dhe arsyetimi i aktgjykimit të Gjykatës Supreme është në kundërshtim me faktet.
  - (iii) Parashtruesi më tej pretendon se gjykatat e rregullta interpretuan ndryshe të njëjtat norma ligjore dhe kanë shkelur parimin e sigurisë juridike dhe si dëshmi të praktikave të ndryshme në lidhje me rastet KI129/18 dhe KI166/18, bashkëngjiten aktgjykimet e Gjykatës Themelore në Prishtinë (Aktgjykimi C. nr. 238/2014 dhe Aktgjykimi C. nr. 179/2018) si dhe aktgjykimin e Gjykatës së Apelit (CA. nr. 3633/2015).
  - (iv) Se shkeljet e neneve tjera kanë rezultuar nga shkelja e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.
34. Parashtruesi i kërkesës si mbështetje të pretendimeve të tij gjithashtu citon Aktgjykimin KI138/15 të Gjykatës Kushtetuese dhe thekson se “[...] aplikimi i të drejtës materiale që mund të ishte fakt determinant për marrjen e aktgjykimit të asaj gjykate, por Gjykata Supreme nuk e zbatoi fare këtë çështje mbi bazën e faktit ligjor”.
35. Parashtruesi i kërkesës pretendon që “Gjykata Kushtetuese duhet të vlerëson nëse procesi gjyqësor në tërësinë e tij ka qenë i drejtë dhe i paanshëm, ashtu sikur edhe kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës (shih, ndër të tjera, *mutatis mutandis*, Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, 16 dhjetor 1992, f. 34, seria A. nr. 247, dhe B. Vidal kundër Belgjikës, 22 prill 1992, f. 33, seria A. nr. 235).
36. Parashtruesi i kërkesës kërkon që Gjykata ta shfuqizojë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, dhe që çështjen ta kthejë në rigjykim.

### **Dispozitat përkatëse ligjore**

#### ***Ligji Nr. 03/L-212 i Punës***

##### *Neni 5*

##### *Ndalimi i të gjitha llojeve të diskriminimit*

1. Diskriminimi është i ndaluar në punësim dhe profesion, lidhur me rekrutimin në punësim, trajnimin, promovimin e punësimit, kushtet e punësimit, masat disiplinore, ndërprerjen e kontratës së punës ose çështjeve të tjera nga marrëdhënia e punës të rregulluara me këtë ligj dhe me ligjet e tjera në fuqi.

[...]

*Neni 10  
Kontrata e Punës*

[...]

5. Kontrata për një periudhë të caktuar që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit më të gjatë se dhjetë (10) vite, konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore.

*Neni 67  
[Ndërprerja e Kontratës së punës sipas fuqisë ligjore]*

1. Kontrata e Punës sipas fuqisë ligjore, ndërpritet:

[...]

1.3. me skadimin e kohëzgjatjes së kontratës;

*Neni 70  
[Ndërprerja e Kontratës së Punës nga ana e punëdhënësit]*

1. Punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit me një periudhë paralajmërimi, atëherë kur:

1.1. ndërprerja e tillë arsyetohet për arsye ekonomike, teknike ose organizative;

1.2. i punësuarit nuk është më i aftë t'i kryejë detyrat e punës;

1.3. punëdhënësi mund ta ndërpresë kontratën e punës në rrethanat e përcaktuara në nënparagrafin 1, 1 dhe 1, 2 të këtij paragrafi nëse është e papërshtatshme për punëdhënësin që ta transferojë të punësuarin në një vend pune tjetër, ta trajtojë a ta kualifikojë atë për ta kryer punën ose ndonjë punë tjetër;

1.4. punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit në periudhën e kërkuar të paralajmërimit të ndërprerjes në:

1.4.1. rastet e rënda të sjelljes së keqe të punonjësit; dhe

1.4.2. për shkak të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës.

1.5. punëdhënësi duhet ta njoftojë të punësuarin për largimin e tij/saj menjëherë pas rastit që shpie në largim, ose sapo punëdhënësi të jetë vënë në dijeni të atij rasti;

1.6. punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit pa periudhën e kërkuar të paralajmërimit të ndërprerjes, atëherë kur:

1.6.1. i punësuarit është fajtor për përsëritjen e një keqsjelljeje më pak serioze ose të shkeljes së detyrimeve;

1.6.2. performanca e të punësuarit mbetet e pakënaqshme përkundër paralajmërimit me shkrim.

2. Punëdhënësi mund ta ndërpresë kontratën e punës në bazë të nënparagrafit 1.6 të paragrafit 1 të këtij neni vetëm atëherë kur i punësuarit ka marrë përshkrimin në formë të shkruar të performancës së pakënaqshme, një afat të përcaktuar kohor brenda të cilit i punësuarit duhet ta përmirësojë performancën e vet, si dhe një deklaratë se dështimi për përmirësimin e performancës do të rezultojë me largim nga puna pa asnjë paralajmërim të mëtejshëm me shkrim.

[...]

Neni 71

[Koha e njoftimit për ndërprerjen e kontratës së punës]

1. Punëdhënësi mund të ndërpresë kontratën e punës në kohë të pacaktuar në bazë të nenit 70, të këtij ligji në këto intervale kohore të njoftimit:

1.1. prej gjashtë (6) muaj deri në dy (2) vite punësim, tridhjetë (30) ditë kalendarike;

1.2. prej dy (2) deri në dhjetë (10) vite punësimi, dyzet e pesë (45) ditë kalendarike;

1.3. mbi dhjetë (10) vite punësim, gjashtëdhjetë (60) ditë kalendarike.

2. Punëdhënësi mund të ndërpresë kontratën e punës për kohë të caktuar me njoftim prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike. Punëdhënësi i cili nuk ka për qëllim të ripërtërijë kontratën me periudhë të caktuar duhet të informojë të punësuarin së paku tridhjetë (30) ditë para skadimit të kontratës. Dështimi për ta njoftuar nga punëdhënësi, do t'i japë të drejtën të punësuarit për zgjatjen e tridhjetë (30) ditëve kalendarike shtesë me pagë të plotë”.

**Marrëveshja për Partneritet Publiko-Privat për Operimin dhe Zgjerimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës**

**9.18 [Përfundimi i Personelit]**

“Partneri Privat mund të përfundoj punësimin ose ndonjë angazhim të cfarëdo punëtori të ANP (i) në çdo kohë për çështjet në lidhje me ligjet, rregullat, dhe rregulloret administrative dhe dekretet e aplikuar (ii) sipas marrëveshjes së përbashkët , dhe (iii) pa kufizime pas përvjetorit të tretë (3) të datës së hyrjes në fuqi”.

**Pranueshmëria e kërkesës**

37. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

38. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

39. Gjykata po ashtu i referohet paragrafit 4, të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, që përcakton: “Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme”.



40. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqes ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejnë për individët dhe personat juridikë (shih: rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI41/09, parashtruesi i kërkesës *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 shkurtit 2010, par. 14).
41. Në vazhdim, Gjykata vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata së pari u referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47  
[Kërkesa individuale]

1. *Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*
2. *Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të këtë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*

Neni 48  
[Saktësimi i kërkesës]

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.*

Neni 49  
[Afati]

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor”. [...]*

42. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi është palë e autorizuar, i cili konteston aktin e një autoriteti publik, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kushtet nga neni 48 i Ligjit, dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
43. Megjithatë, Gjykata i referohet paragrafit (2) të rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, i cili përcakton:
- (2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.*
44. Gjykata së pari vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se i është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, sepse aktgjykimi i Gjykatës Supreme

nuk është arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme, përderisa shkeljet e të drejtave të tjera të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ i pretendon si rezultat i shkeljes së të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

45. Në thelb, parashtruesi i kërkesës e arsyeton kërkesën e tij në lidhje me aplikimin e gabuar të së drejtës procedurale dhe materiale, duke theksuar se aktgjykimi i Gjykatës Supreme nuk ka arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme si në vijim:

- (i) Se Gjykata Supreme ka dalë përtej kërkesës së revizionit kur interpretoi nenin 5, paragrafi 1 të Ligjit të Punës.
- (ii) Se Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit kanë zbatuar në mënyrë të drejtë ligjin në lidhje me nenin 1.1 dhe nenin 67, paragrafi 1.3, si dhe nenin 71 paragrafi 2 të Ligjit të Punës, 03/L-212, ndërsa Gjykata Supreme ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale dhe arsyetimi i aktgjykimit të Gjykatës Supreme është në kundërshtim me faktet.
- (iii) Parashtruesi më tej pretendon se gjykatat e rregullta interpretuan ndryshe të njëjtat norma ligjore dhe kanë shkelur parimin e sigurisë juridike dhe si dëshmi të praktikave të ndryshme në lidhje me rastet KI129/18 dhe KI166/18, bashkëngjiten aktgjykimet e Gjykatës Themelore në Prishtinë (Aktgjykimi C. nr. 238/2014 dhe Aktgjykimi C. nr. 179/2018) si dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit (CA. nr. 3633/2015).
- (iv) Se shkeljet e neneve tjera kanë rezultuar nga shkelja e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

46. Gjykata, duke i marrë parasysh pretendimet e parashtruesit, do i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GEDNJ), e cila obligon Gjykatën që në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, të interpretojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë në harmoni me vendimet gjyqësore të GJEDNJ-së.

**(i) *Sa i përket pretendimeve për shkelje të së drejtës së parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, në lidhje me tejkalimin e kompetencave të Gjykatës Supreme***

47. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme doli përtej kërkesës së revizionit gjatë interpretimit të nenit 5 të Ligjit të punës.
48. Bazuar në atë që u tha më lart, në lidhje me pretendimet konkrete të parashtruesit të kërkesës për tejkalimin e kompetencave nga ana e Gjykatës Supreme, Gjykata rikujton se juridiksioni konkret i secilës gjykatë të rregullt përcaktohet me rregullat përkatëse ligjore. Lidhur me këtë rast konkret, në paragrafin 2.2 të nenit 2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore theksohet se “Gjykata i zbaton rregullat e të drejtës materiale sipas çmuarjes së saj dhe nuk është e lidhur me thëniet e palëve që kanë të bëjnë me të drejtën materiale”.
49. Në lidhje me këto pretendime të parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se Gjykata Supreme arsyetoi se “paditësja te paraardhësi i të paditurës ka qenë e

punësuar në një kohë të caktuar prej 14.02.2005. deri më 3.04.2011, kur u dha në koncesioni ANP "Adem Jashari", dhe më tej kur me kontratën e fundit i është vazhduar marrëdhënia e punës deri më 03.04.2014, edhe pse vendi i punës ka pasur natyrë të punësimit të përhershëm. Kontrata të tilla, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, janë në kundërshtim me parimin e ndërgjegjshmërisë dhe ndershmërisë, ku 9 vjet e 2 muaj rresht paditësja mbahet në gjendje të pasigurt juridike të marrëdhënies së punës, me vazhdimin e marrëdhënies së punës për një kohë të caktuar dhe në fund njoftimit të ndërprerjes së kontratës së punës e cila nuk ka bazë ligjore. Punëdhënësi nuk mund të heqë dorë nga të drejtat e punëtorëve që rrjedhin nga dispozitat përkatëse të nenit 5 par. 1 të Ligjit të Punës, ku parashihet se është e ndaluar çfarëdo diskriminimi në punësim dhe profesion, lidhur me rekrutimin në punësim, trajnimin, promovimin e punësimit, kushtet e punësimit, masat disiplinore, ndërprerjen e kontratës së punës ose çështjeve të tjera nga marrëdhënia e punës të rregulluara me këtë ligj dhe me ligjet e tjera në fuqi. I padituri nuk arriti të argumentojë faktin se gjatë zbatimit të Marrëveshjes së PPP të lidhur ndërmjet të paditurit dhe të Republikës së Kosovës, ka zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitën e nenit 5.1 të Ligjit të Punës.”.

50. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë në lidhje me tejkalimin e kompetencave të Gjykatës Supreme janë të pabazuara në baza kushtetuese.

**(ii) Sa i përket pretendimeve për shkelje të së drejtës së parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, në lidhje me vendimin e pa-arsyetuar**

51. Në këtë drejtim, Gjykata së pari thekson se funksioni thelbësor i një vendimi të arsyetuar, është t'u tregojë palëve se janë dëgjuar. Për më tepër, një vendim i arsyetuar i jep një pale mundësinë për t'u ankuar kundër tij, si dhe mundësinë e shqyrtimit të vendimit nga një organ i apelit. Vetëm duke dhënë një vendim të arsyetuar mund të ketë shqyrtim publik të administrimit të drejtësisë (shih *mutatis mutandis*, rastet e GJEDNJ-së, *Hirvisaari kundër Finlandës*, nr. 49684/99, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001, paragrafi 30; dhe shih gjithashtu *Suominen kundër Finlandës*, nr. 37007/97, Aktgjykim i 1 korrikut 2003 paragrafi 37; si dhe shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI97/16 parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykim i 4 dhjetorit 2017, paragrafi 46 ).
52. Gjykata thekson se, përderisa nuk është e nevojshme që gjykata të merret me çdo pikë të ngritur në argument (shih gjithashtu rastin e GJEDNJ-së, *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994, paragrafi 61), argumentet kryesore të parashtruesve të kërkesës duhet të adresohen (Shih rastet e GJEDNJ-së, *Buzescu kundër Rumanisë*, nr. 61302/00, Aktgjykimi i 24 majit 2005 dhe *Pronina kundër Ukrainës*, nr. 63566/00, Aktgjykim i 18 korrikut 2006). Po ashtu, dhënia e një arsyeje për një vendim që nuk është një arsye e mirë në ligj nuk do të përmbushë kriteret e nenit 6 (Shih rastin e GJEDNJ-së *De Moor kundër Belgjikës*, nr. 16997/90, Aktgjykimi i 23 qershorit 1994 si dhe rastin e Gjykatës Kushtetuese *IKK Classic*, cituar më lart, paragrafi 51).

53. Gjykata rikujton se Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj arsyetoi se duke u nisur nga kjo gjendje faktike e rastit, Gjykata Supreme ka "... gjetur se gjykatat më të ulëta kanë zbatuar gabimisht të drejtën materiale (224.1 LPK), kur kanë gjetur se njoftimi i të paditurës për ndërprerje të kontratës së punës është i ligjshëm, sepse marrëdhënia e punës paditëses i është ndërprerë në pajtim me nenin 67 të Ligjit të punës, dhe në procedurën e përcaktuar me nenin 71, paragrafi 2 i Ligjit të punës dhe nenin 1.1 të kontratës së punës, e cila ishte për një kohë të caktuar për periudhën prej 1.11.2013 deri më 03.04.2014, dhe se pas kësaj periudhe, nuk ka asnjë detyrim ndaj paditëses. Përfundimi i tillë i gjykatës së shkallës së parë nuk është në përputhje me shkresat e lëndës, sepse nga provat e përfshira në to, konkretisht njoftimi me shkrim i të paditurës i 3.03.2014 rrjedh se paditëses nuk i është vazhduar marrëdhënia e punës në pajtim me politikat e Bordit të Drejtorëve, të Ligjit të Punës, si dhe vendimit për planifikimin e ardhshëm të resurseve njerëzore dhe Marrëveshjen e Partneriteti t Publik-Privat (PPP), e cila ishte e lidhur ndërmjet të paditurit dhe të Republikës së Kosovës, siç është cekur në këtë njoftim".
54. Gjykata Supreme i kishte sqaruar parashtresit të kërkesës që ai ka dështuar të vërtetojë të gjitha pretendimet e tij lidhur me ligjshmërinë për mosvazhdimin e kontratës së punës si dhe vërtetimin i fakteve relevante, përkatësisht, nëse ai ka përpiluar një plan të detajuar operativ, në të cilin do të përcaktohej se cilat shërbime mund të reduktohen dhe në çfarë përfshirje do të ishin reduktuar, me qëllim të vërtetimit të faktit se provat e parashtruara, paraqesin bazë të vlefshme ligjore për mospërtërirjen e kontratës së punës.
55. Gjykata Supreme më tej shpjegoi: "... që nuk e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm, qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë se paditësi ishte në marrëdhënie pune për një periudhë të caktuar kohore dhe se nuk kanë kaluar 10 vjet në kuptim të nenit 10.5 të Ligjit të punës, në mënyrë që marrëdhënia e punës së paditësit të trajtohej për një periudhë të pacaktuar, sepse objekt i kërkesëpadisë së paditësit nuk është të përcaktojë ekzistencën e marrëdhënies së punës së paditësit për një periudhë të pacaktuar kohore, por vlerësimin e ligjshmërisë së njoftimit për mospërtëritjen e kontratës së punës, që ishte nxjerrë në kundërshtim me Ligjin e Punës, që është ligj themelor që rregullon marrëdhënien e punës në Kosovë, ku janë përcaktuar bazat dhe procedurat për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të një punëtori, të cilin i padituri nuk e ka respektuar me rastin e mosvazhdimin të kontratës së punës paditëses, dhe si rezulton se mosvazhdimi i kontratës së punës është i kundërligjshëm".
56. Në fund, lidhur me pretendimin e parashtresit dhe konkretisht në lidhje me citimin e rastit të Gjykatës Kushtetuese, përkatësisht Aktgjykimin KI138/15, Gjykata rikujton se rasti në fjalë dallon nga rastet pranë nesh për arsyet si në vijim: (i) çështja e procedurës disiplinore ndaj punëtorit të parashtresit në atë rast ishte trajtuar në mënyra të ndryshme nga gjykatat e rregullta; (ii) është e paqartë baza juridike me të cilën është zhvilluar procedura disiplinore; dhe (iii) kishte elemente kontradiktore në vendimet e gjykatave të instancave më të ulëta. Për më tepër, Gjykata e Apelit kishte zbatuar dhe kishte përdorur për arsyetim një Udhëzim Administrativ i cili zbatonte një Rregullore për Shërbyesit Civilë, e jo Ligjin e Punës. Ky argument edhe pse ishte i ngritur nga parashtresi i kërkesës në atë rast, nuk ishte shqyrtuar nga Gjykata Supreme



(shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI138/15, *Sharr Beteiligung GmbH*, Aktgjykim i 4 shtatorit 2017).

57. Gjykata përsërit se neni 6 i KEDNJ-së dhe neni 31 i Kushtetutës, i obligon gjykatat të japin arsye për vendimet e tyre, por kjo nuk mund të kuptohet si obligim i gjykatës për të dhënë përgjigje të hollësishme në çdo argument të parashtruesit të kërkesës (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994, paragrafi 61). Shkalla në të cilën zbatohet obligimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë sipas natyrës së vendimit. Ajo gjithashtu duhet të marrë parasysh, ndër të tjera, shumëllojshmërinë e parashtrësive të paraqitura nga një palë në procedurat që mund të bëjnë që gjykatat të japin mendime dhe përfundime të ndryshme ligjore gjatë marrjes së vendimeve. Prandaj, pyetja nëse gjykata ka përmbushur detyrimin për të shpjeguar arsyet për vendimin e saj, që rrjedh nga neni 6 i Konventës, mund të përcaktohet vetëm në dritën e rrethanave të secilit rast individual.
58. Bazuar në sa u tha më sipër, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria). Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 28).
59. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet se procedurat përkatëse në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe se me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së, *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, Vendimi i 30 qershorit 2009).
60. Si rrjedhojë, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit për cenimin e parimit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nga ana e Gjykatës Supreme është i papabazuar në baza kushtetuese.

**(iii) Sa i përket pretendimeve për shkelje të së drejtës së parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, në lidhje me parimin e sigurisë juridike**

61. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se “gjykatat e rregullta për të njëjtën çështje kontestimore [...] kanë nxjerrë vendime të ndryshme”, duke iu referuar kështu kërkesave KI129/18 dhe KI166/18 dhe duke i bashkëngjitur kështu dy vendime të Gjykatës Themelore dhe një vendim të Gjykatës së Apelit.
62. Gjykata fillimisht thekson se ka pasur disa raste kur parashtruesit e kërkesës kanë ngritur çështjen e “vendimeve kundërthënëse” të gjykatave të rregullta (Shih rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI29/17, *Adem Zhegrova*, Aktvendim për papranueshmëri, i 2 tetorit 2017 si dhe rastin KI42/18, *Kushtrim Ibraj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 dhjetorit 2017), Për më tepër, edhe GJEDNJ-ja këto raste i ka trajtuar në kuadër të parimit të sigurisë juridike



(Shih *mutatis mutandis* rastin e GJEDNJ-së, *Nejdet Sahin dhe Perihan Sahin kundër Turqisë*, nr. 13279/05, Aktgjykim i 20 tetorit 2011, paragrafi 52).

63. GJEDNJ përmes praktikës gjyqësore të saj, ka pohuar se kërkesat e sigurisë juridike dhe mbrojtja legjitime e besimit të publikut nuk japin dhe as nuk garantojnë një të drejtë të fituar në përputhshmëri me praktikën gjyqësore. (shih rastin e GJEDNJ-së, *Unedic kundër Francës*, nr. 20153/04, Aktgjykim i 18 dhjetorit 2008, paragrafi 74 si dhe shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI42/18 *Kushtrim Ibraj*, cituar më lart, paragrafi 34).
64. Gjykata rikujton se GJEDNJ, gjithashtu ka përcaktuar përmes praktikës së saj gjyqësore, se përveç kur ekziston "arbitraritet i dukshëm", nuk është roli i Gjykatës të vë në pikëpyetje interpretimin e ligjit vendor nga gjykatat kombëtare. (Shih rastin e GJEDNJ-së *Adamsons kundër Letonisë*, nr. 3669/03, Aktgjykim i 24 qershorit 2008, paragrafi 118 si dhe rastin e Gjykatës Kushtetuese KI42/18 *Kushtrim Ibraj*, cituar më lart, paragrafi 38).
65. Megjithatë, Gjykata fillimisht vëren se në rastin e bashkëngjitur nga parashtruesi i kërkesës faktet janë si vijon: (i) i punësuar L. A. ishte i punësuar në ANP dhe më pas tek parashtruesi; (ii) parashtruesi i kërkesës, të punësuarin L. A., me anë të njoftimit për mospërtërirje të kontratës së punës e kishte lajmëruar se nuk do t'i vazhdohet marrëdhënia e punës; dhe (iii) i punësuar L. A. kishte parashtruar padi në Gjykatën Themelore për anulim të njoftimit të parashtruesit të kërkesës. Gjykata Themelore, me Aktgjykimin C. nr. 238/2014, të 25 majit 2015, e kishte refuzuar padinë e të punësuarit L. A. si të pabazuar. Ky Aktgjykim i Gjykatës Themelore pas ankesës së të punësuarit L. A. u kthye në gjykatën e shkallës së parë në riprocedurë dhe vendosje nga ana e Gjykatës e Apelit [Aktvendimi CA. nr. 3633/2015] të 19 marsit 2018, vendim ky që e aprovoi si të bazuar ankesën e të punësuarit L. A.
66. Mirëpo, Gjykata vëren se vendimet me të cilat parashtruesi i kërkesës përpiket të dëshmojë praktikën e ndryshme të gjykatave të rregullta lidhur me të punësuarin L. A., dhe të cilat parashtruesi i kërkesës i ka cituar dhe bashkëngjitur, janë vendimet të cilat nuk janë të formës së prerë dhe sipas të njëjtave ekziston mundësia e paraqitjes së mjeteve juridike nga ana e kundërt në kontest.
67. Gjithashtu, parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar dëshmi se këto vendime janë vërtetuar nga Gjykata Supreme e Kosovës dhe se këto konteste përfunduan në mënyrë përfundimtare në dobi të parashtruesit të kërkesës. Prandaj, Gjykata nuk do të lëshohet në analizë krahasuese të këtyre vendimeve dhe vendimeve të kontestuara të parashtruesit të kërkesës, sepse kjo analizë është e pamundur, duke pasur parasysh se parashtruesi i kërkesës i referohet vendimeve të cilat nuk janë të formës së prerë.
68. Si rrjedhojë, Gjykata konstaton se nuk do të merr parasysh pretendimet e parashtruesit lidhur me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, C. nr. 179/18, të 18 gushtit 2018, i cili është nxjerrë pas Aktvendimit CA. nr. 3633/2015 të Gjykatës së Apelit, sepse parashtruesi i kërkesës nuk e ka njoftuar Gjykatën se a është ankuar tutje pala tjetër [i punësuar L. A.] dhe në çfarë procedure gjendet kjo

lëndë, gjë që është e mundur sipas këshillës juridike të Aktgjykimit [C. nr. 179/18].

69. Gjykata vë në pah që në rastin konkret Gjykata Supreme i kishte arsyetuar parashtruesit të kërkesës se objekt i shqyrtimit ka qenë ligjshmëria e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, prandaj Gjykata Supreme kishte gjetur se nuk iu kishte ndërprerë marrëdhënia e punës të punësuarit sipas dispozitave ligjore në fuqi.
70. Prandaj, Gjykata konstaton se pretendimi i parashtruesit për cenimin e parimit të sigurisë juridike është i pabazuar në baza kushtetuese.

**(iv) *Sa i përket pretendimeve për shkelje të neneve 24, 32 dhe 46 të Kushtetutës***

71. Në fund, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës ndërlidh shkeljen e nenit 24, 32 dhe 46 të Kushtetutës, si dhe Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës.
72. Parashtruesi i kërkesës vetëm ka përmendur këto nene, pa sqaruar dhe elaboruar se si ato kanë rezultuar në shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese si pasojë e pretendimit të tij për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, Gjykata konsideron se nuk ka nevojë të shqyrtohen si pretendime të veçanta.
73. Gjykata rikujton se fakti i thjeshtë se parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur me rezultatin e vendimeve të Gjykatës Supreme apo përmendja e neneve të Kushtetutës nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (Shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese KI136/14, *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33).
74. Si rrjedhojë, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit për shkeljen e të drejtës së tij për barazi para ligjit, mjete juridike dhe të drejtës pronësore, janë të pabazuara në baza kushtetuese.

***Përfundim***

75. Gjykata konsideron që pretendimi i parashtruesit për shkeljen e të drejtës së tij kushtetuese për gjykim të drejtë dhe të paanshëm për shkak të cenimit të parimit të arsyetimit të vendimit gjyqësor si dhe pretendimit për tejkalim të kompetencës nga ana e Gjykatës Supreme, si dhe pretendimit të parashtruesit për cenimin e parimit të sigurisë juridike janë të pabazuara në baza kushtetuese. Gjithashtu, pretendimet për shkeljen e të drejtës së tij për barazi para ligjit, mjete juridike dhe të drejtës pronësore, janë të pabazuara në baza kushtetuese.
76. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur dëshmi, fakte dhe argumente që tregojnë se procedurat në gjykatat e rregullta kanë paraqitur në ndonjë mënyrë shkelje kushtetuese të të drejtave të

tyre të garantuara me Kushtetutë, me të cilat pretendohet se shkelin të drejtën e tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe nenet 24, 32 dhe nenin 46 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

77. Rrjedhimisht, Gjykata vjen në përfundim se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe deklarohet e papranueshme, në pajtim me nenin 113, paragrafi 7 të Kushtetutës dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, dhe rregullit 39 (2) të Rregullores së punës, më 20 qershor 2019, njëzëri

### **VENDOS**

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**

*Radomir Laban*

Radomir Laban



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

*Arta Rama-Hajrizi*

Arta Rama-Hajrizi